



Në bazë të nenit 21 dhe 22 të Ligjit bazik nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, lidhur me nenin 13 të Ligjit nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Bazik për Ndërmarrjet Publike, nenit 29 paragrafi 3 pika 6, nenit 30 pika 8 të Statutit të ndërmarrjes nr.01-338/2022 të datës 21.02.2022, nenit 15 paragrafi 3 pika 10 dhe nenit 25 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative, nenit 3 të Rregullores nr.01-1974/17 për Sistematizimin e Vendeve të Punës të datës 27.07.2017, Vendimit nr.01-2110/22 të datës 28.09.2022, Konkursit nr.01-2139/22 të datës 29.09.2022, Tabelarit të vlerësimit të kandidatëve të datës 29.11.2022, Bordi i Drejtorëve i Ndërmarrjes Publike Qendrore “Posta e Kosovës” Sh.A. më date 30.11.2022 mori këtë:

V E N D I M

1. Kandidate e suksesshme për pozitën e punës Kryeshef Ekzekutiv sipas konkursit nr.01-2139/22 të datës 29.09.2022 përzgjedhet znj. Nora Rraci;
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Kryeshefit Ekzekutiv janë të përcaktuara më ligjet në fuqi dhe aktet e brendshme të ndërmarrjes;
3. Mandati i Kryeshefit Ekzekutiv sipas pikës 1 të këtij vendimi është 3 vite;
4. Kompensimi bëhet sipas politikave të brendshme të ndërmarrjes;
5. Vendimi hynë në fuqi menjëherë.

Arsyetim

Bordi i Drejtorëve me vendimin nr.01-2110/22 të datës 28.09.2022 kishte shpallur konkurs publike nr. nr.01-2139/22 të datës 29.09.2022 për pozitën e punës Kryeshef Ekzekutiv në NPQ “Posta Kosovës” Sh.A.

Në konkursin për Kryeshef Ekzekutiv kishin aplikuar gjithsej 33 kandidat. Pas shqyrtimit dhe verifikimit të aplikacioneve 18 kandidat kanë plotësuar kriteret e konkursit ndërsa 15 kandidatë nuk kanë plotësuar kriteret e konkursit, të cilëve iu është dhënë mundësia që në afat prej 3 ditëve të paraqesin vërejtjet e tyre. Asnjë kandidat nuk ka paraqitur vërejte në lidhje me shqyrtimin e aplikacioneve.

Intervistat me gojë janë zhvilluar në datat 25 dhe 29 nëntor 2022, ku prej 18 kandidatëve në intervistë me gojë kanë marrë pjesë 13 kandidat, prej të cilëve me më së shumti pikë nga Bordi i Drejtorëve është vlerësuar znj. Nora Rraci me gjithsej 26 pikë nga maksimumi prej 30 pikëve.

Bordi i Drejtorëve konstaton që i gjithë procesi i rekrutimit për pozitën e punës Kryeshef Ekzekutiv ka qenë transparent, i rregullt dhe në bazë të Ligjit, Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative si dhe në bazë të Statutit të ndërmarrjes dhe përzgjedhja e kandidates së suksesshme është bërë në mënyrë meritore në bazë të profesionalizmit dhe performancës së treguar në intervistë, andaj dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryesues i Bordit të Drejtorëve
Fadil Bejta

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të ushtroj padi në afat prej 30 ditëve në Gjykatën Themelore në Prishtinë.